 <p>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</p>	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë**




**MANUAL UDHËZUES**

**Për Operatorët Ajrorë për Marrëveshjet e Ndarjes së Kodit të Marketingut  
(Code Share)**

**QERSHOR 2020**

Data e botimit: 26/06/2020	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 1 nga 11
----------------------------	------------------	----------------

 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

## Hyrje

Ky dokument është pronë e:

**Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë**

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1

Pranë Parkut të Delegacioneve

Tiranë / Shqipëri

Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjësin përgjegjës.


Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

Edlira Kraja,

**Drejtor Ekzekutiv**

Data e botimit: 26/06/2020	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 2 nga 11
----------------------------	------------------	----------------


 <small>AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL</small>	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

### PARATHËNIE

Ky manual është hartuar duke pasur parasysh dispozitat e Udhëzimit të Ministrit N.3, datë 7.02.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar dhe Urdhërit të Ministrit Nr. 59, datë 30.01.2020 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”.

### LISTA E FAQEVE EKZISTUESE


Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë		Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë

	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

### SHKURTIME


Në këtë manual do të përdoren shkurtime e mëposhtme, të cilat do të nënkuptojnë:

AOC	Certifikata e Operatorit Ajror
AACSH	Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (këtej e tutje i referohet si Autoriteti)
EASA	Agjencia Europiane e Sigurisë në Aviacion
FOD	Departamenti i Operimeve të Fluturimit/zyra e OPS-it
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IOSA	Audit i Sigurisë në Operim të IATA-s
VQA	Vend Qëndrimi i Avionëve (Ramp)

	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

## Tabela e Përmbajtjes

Lista e faqeve ekzistuese .....	3
Tabela e miratimit.....	4
Lista e shpërndarjes.....	4
Tabela e rishikimeve.....	4
Shkurtime.....	5
1.Hyrje.....	7
1.1 Referencat ligjore.....	7
1.2 Ndarja e kodit.....	7
1.3 Qëllimi i manualit.....	7
2. Rolet dhe Përgjegjësitë. ....	7
3. Politikat.....	7
4. Veprimi që kërkohet .....	11
5. Pyetje që kërkojnë sqarim.....	11

	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

## 1. Hyrje

1.1 Ky Manual Udhëzues bazohet në dispozitat e Urdhrit të Ministrit Nr. 59, datë 30.01.2020 “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore” si dhe Udhëzimit të Ministrit N.3, datë 7.02.2011 “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, i ndryshuar.

1.2 "Ndarja e kodit" nënkupton një marrëveshje marketingu sipas së cilës një operator vendos kodin e tij të përcaktuar, në një fluturim të operuar nga një operator tjetër, dhe shet dhe lëshon biletat për atë fluturim.

1.3 Qëllimi i këtij Manuali Udhëzues është të informojë dhe udhëzojë operatorët ajrorë shqiptarë se si duhet të arrihet pajtueshmëria me ORO.AOC.115 dhe ARO.OPS.105 dhe Mjetet e Pranueshme të Pajtueshmërisë (AMC) dhe Materialit Udhëzues (GM).

## 2. Rolet dhe Përgjegjësitë

2.1 Operatorët Shqiptarë - të bëjnë deklaratat për ndarjen e kodit të marketingut pranë AACSH në lidhje me marrëveshjet për ndarjen e kodit me operatorin e huaj, duke vendosur programe të përshtatshme auditimi në përputhje me kërkesat e zbatueshme.

2.2 AACSH - të pranojë deklaratat fillestare dhe rinovimin e ndarjes së kodit të marketingut për të kontrolluar nëse janë përmbushur kërkesat e zbatueshme.


## 3. Politika

3.1 "Aplikimi i Standarteve të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO)" të përmendura në ORO.AOC.115 dhe ARO.OPS.105 do të thotë: Vetë Konventa, plus Anekset 1, 6, 8 dhe 19; dhe Aneksi 18 sipas rastit.

3.2 Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA) dhe Auditi Ndërkombëtar i Sigurisë Operacionale (IOSA) të IATA-s duhet të konsiderohet si standard i paracaktuar, dhe fushëveprimi i çdo auditi të brendshëm ose të palëve të treta duhet të kontrollojë pajtueshmërinë me të paktën të njëjtat Standarde të ICAO-s.

3.3 Në vijim do të gjeni "Informacionin e dokumentuar" që duhet të dorëzohet për marrëveshje fillestare, rinovimi dhe ndryshimi të ndarjes së kodit të marketingut:

Data e botimit: 26/06/2020	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 7 nga 11
----------------------------	------------------	----------------

	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

**A. Detajet e operatorit të huaj:**

1. Emri i operatorit të huaj;
2. Numri i AOC-së;
3. Adresa;
4. Shteti;
5. Numri i telefonit;
6. E-mail-i.

**B. Të dhënat e AOC së operatorit shqiptar:**


1. Emri i operatorit shqiptar me AOC;
2. Numri i AOC-së;
3. Adresa;
4. Numri i telefonit;
5. E-mail-i;
6. Deklarata:

6.1 Ne kemi hyrë në këtë marrëveshje të ndarjes së kodit të marketingut me operatorin e huaj të specifikuar më lart.

6.2 Ne konfirmojmë se kemi verifikuar që operatori i huaj është në përputhje me standartet e aplikueshme të ICAO-s.

6.3 Bashkëngjitur ne kemi informacionin e dokumentave të kërkuara për t'i krijuar mundësinë AACSH për t'i parë në përputhje me ARO.OPS.105.

Data e botimit: 26/06/2020	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 8 nga 11
----------------------------	------------------	----------------

	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

6.4 Emrin e Menaxherit të AOC që autorizohet të bëjë këtë deklaratë.

6.5 Nënshkrimin.

C. Detajet e operatorit të huaj të ndarjes së kodit të marketingut:

1. Tipat e avionëve në operatorin e huaj AOC;
2. Tipat e avionëve që do të përdoren sipas ndarjes së kodit të marketingut;
3. Rajonin e operimeve ku do të përdoret ndarja e kodit të marketingut.


D. Mbikqyrja e masave të marra:

1. Menaxheri përgjegjës i operatorit ajror shqiptar për programin e auditit;
2. Shpeshësia e auditeve, fusha e kontrollit dhe vendndodhja (et);
3. Detajet e çfarëdo lloj auditit të një pale të tretë, p.sh. IOSA;
4. Verifikimi i kompetencës së auditorëve të palës së tretë, n.q.s nuk janë nga IOSA;
5. Planifikime të tjera të mbikqyrjes së masave të marra, p.sh. inspektimet në VQA, inspektimet në fluturim;
6. Raporti i auditit fillestar dhe deklarata e përputhshmërisë së auditit (shiko AMC1 ORO.AOC.115(a)(1), AMC1, AMC1 ORO.AOC.115(b)(a)(1) dhe AMC1 ORO.AOC.115 (b)(e).

3.4 Fusha e pranimit për raportet e auditeve përbëhet sipas standarteve të ICAO-s të adresuara nga IOSA. Çdo lloj auditit i brendshëm ose i një pale të tretë duhet të mbulojë të paktën këto standarde.

Data e botimit: 26/06/2020	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 9 nga 11
----------------------------	------------------	----------------



	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

3.5 Një operator i huaj me Regjistrim IOSA-s është i pranueshëm në qoftë se plotëson këto kërkesa të:

- ORO.AOC.115;
- AMC1 ORO.AOC.115(a)(1);
- AMC1 ORO.AOC.115(b);
- AMC2 ORO.AOC.115(b), paragrafi (a).

Kur bazohemi tek një regjistrim i IOSA-s, duhet të dorëzohet një kopje e raportit të auditit të fundit.

3.6 Operatorët që nuk janë nën fushën e kërkesave të IOSA-s (si rezultat i pajisjeve që janë në operim dhe/ llojit të operimit) duhet të zbatojnë standartet e aplikueshme të ICAO-s, dhe programi i auditit të brendshëm ose auditet e palëve të treta, për pasojë duhet të mbulojnë (dhe zbatojnë) standartet e aplikueshme të ICAO-s të adresuara nga IOSA.


3.7 Kërkesat ORO/ARO nuk mund të aplikohen për (operimet) hyrëse, për masat e marra të ndarjes së kodit të marketingut në mënyrë të njëanëshme ku fluturimi i operatorit shqiptar mban kodin e përcaktuar të një operatori të huaj, por nuk mban kodin e përcaktuar të fluturimit të operatorit shqiptar.

3.8 Programet e auditeve, rinovimi i raportimeve të auditit dhe çfardo rekordi tjetër përkatës të ndarjes së kodit të marketingut të fluturimit duhet të mblidhet nga AACSH si një pjesë e mbikqyrjes rutinë të mbajtësve të AOC-së, Sistemit të Mbikqyrjes së Përputhshmërisë (CMS) dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (teknike) (SMS).

3.9 Kur një mbajtës AOC-je, përdor një palë tjetër të tretë në vend të IOSA-s që të auditojë operatorin e huaj aty duhet të ekzistojë një kontratë e lidhur, dhe organizata konsiderohet si një organizatë nënkontraktore. AACSH duhet të verifikojë që pala e tretë që jep shërbimin plotëson kërkesat e programit të auditit duke kontrolluar:

- fushën e auditimit sipas IOSA-s;
- se si mbajtësi i AOC-së ka verifikuar kompetencën e audituesit; dhe

Data e botimit: 26/06/2020	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 10 nga 11
----------------------------	------------------	-----------------

	<b>Manual Udhëzues për Operatorët Ajrorë për Ndarjen e Kodit të Marketingut</b>	
	Zotëruesi	O3
	Dokumenti	AAC-MU/PT-005

- shpeshtësinë e auditeve.

3.10 Kur në fillim identifikohen gabime ose mos-përputhje, në deklaratën për rinovim ose ndarje të kodit të marketingut, raporti duhet të ngrejë një gjetje të Nivelit 2, dhe të menaxhohet në përputhje me ARO.GEN.350.

#### **4. Veprimi që kërkohet**

Të gjithë operatorët e avionëve për të cilët aplikohet ky Manual Udhëzues, si një pjesë e procesit të kalimit tek Air-OPS, duhet të dorëzojnë të plotësuarat deklarata të ndarjes së kodit të marketingut, me ‘Informacionin e Dokumentuar’ që kërkohet sipas pikës 3.3, në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar. Pas kësaj, duhet të paraqiten edhe deklarata të tilla në lidhje me marrëveshje të reja, rinovimi ose ndryshimi të ndarjes së kodit.

#### **5. Pyetje që kërkojnë sqarim**

5.1 Çdo pyetje e mundshme ose kërkesë për udhëzime të mëtejshme nga mbajtësit e COA-së duhet të adresohet zyrtarisht në adresën e emailit: [info@acaa.gov.al](mailto:info@acaa.gov.al)